



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 89/1 prot.

Shkodër, më 04.02.2025

Lënda: Mbi Vendimin nr. 1, datë 27.01.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 24, të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", i ndryshuar, të VKB Fushë Arrëz nr. 3, datë 30.01.2024 "Për miratimin e kritereve për përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i ndihmës ekonomike i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2024", shqyrtoi VKB Fushë Arrëz nr. 1, datë 27.01.2025 "Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke përdorur 6 % të fondit total të ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor 2024".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni për trajtimin e 33 familjeve në shumën 122 450 lekë, duke përdorur deri në 6% të fondit total të ndihmës ekonomike prej 2 080 561 lekë për muajin Dhjetor 2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI

